



# BULETIN INFORMATIV

**Inaugurohen ambientet e rikonstruara të Stacionit të Policisë së Belshit.**

Aktivitetet e muajit Janar 2022

## AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Inaugurohen ambientet e rikonstruara të Stacionit të Policisë së Belshit.
- ◆ SCPA vijon me vizitat në DVP –të e Tiranës, Durrësit dhe Fierit
- ◆ Takime monitoruese në komisaritet DVP Elbasan dhe Shkodër
- ◆ Takim në Drejtorinë e Rendit Publik në DPPSh.
- ◆ Përfundon procesi i seleksionimit të projekteve fituese të raundit të 6-të
- ◆ Takime ndërgjegjësimi me të rinjtë të shkolles “Misto Mame”
- ◆ NSPK-të për edukimin dhe punën me të rinjtë vazhdojnë punën për aktivitetet ndërgjegjësuere



Me 7 janar 2022 u mbajt ceremonia e inaugurimit të ambienteve të rikonstruara të Stacionit të Policisë së Belshit, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan. Në këtë ceremoni morën pjesë drejtues të nivelit të lartë të Policisë së Shtetit si nga drejtoria e përgjithshme ashtu edhe nga drejtoria vendore, përfaqësues të ambasadës suedeze dhe ekipi i menaxhimit të programit SCPA. Vendimi për këtë ndërhyrje në Belsh u mor bashkë me Policinë e Shtetit për shkak të gjendjes së rrënuar dhe pothuajse jashtë funksioni të këtyre ambienteve ku punonjësit e policisë duhej të jepnin shërbime për qytetarët. Si rezultat i një investimi prej 41.000 euro, tani punonjësit e policisë së Belshit kanë ambiente shumë të mira pune që janë dhe mikpritëse për

qytetarët e Belshit. Programi SCPA ka punuar në disa drejtime njëkohësisht duke rritur kapacitetin e punonjësve të policisë, përmirësuar dhe modernizuar shërbimet, infrastrukturën dhe pajisjet. Si nga Ambasada Suedeze ashtu dhe nga Policia e Shtetit u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm. Përfaqësuesja e Ambasadës Suedeze ritheksoi vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes së Qeverisë Suedeze për Policinë Shqiptare në rrugën e saj për demokratizimin dhe forcimin e policimit në komunitet dhe



### SCPA vijon me vizitat në DVP – të e Tiranës, Durrësit dhe Fierit



Gjatë muajit Janar 2022, ekipi i ekspertëve të SCPA ka zhvilluar takime vlerësuese në Komisaritet dhe stacionet e policisë të DVP Tiranë (6 komisaritet e Tiranës + komisaritin e Kavajës), DVP Durrës (komisaritin e Durrësit, Shijakut dhe Krujës) dhe DVP Fier (Komisaritin e Fierit, Lushnjës, Mallakastrës dhe Divjakës).

Këto takime vijnë menjëherë pas takimeve fillestare që janë zhvilluar me nivelin drejtues të DVP-ve të mësipërme ku përveç drejtorëve të DVP-ve, ishin të pranishëm dhe zv/drejtorët përkatës për Sigurinë Publike që janë caktuar me funksionin Drejtues të Grupit të Projektit për Zbatimin e Ndryshimeve si dhe Shefat e komisariateve kryesore.

Synimi i takimeve ishte të vlerësohej procesi i ndryshimeve të kryer gjatë këtyre muajve të fundit në komisaritet e varësisë.

Ekipi diskutoi me nivelin drejtues për punën e deritanishme, për rezultatet e pritshme, si dhe gjendjen aktuale në lidhje me raportin përfundimtar lidhur me zbatimin e ndryshimeve që përcaktohen në udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të DVP.

Fillimisht, në të gjitha takimet u prezantuan disa prej ndryshimeve që tashmë kanë filluar të zbatohen në terren.

Shefat e komisariateve informuan ekspertët e ekipit për hapat e ndërmarrë deri më tani për të zbatuar ndryshimet e parashikuara nga Urdhri i DP dhe Udhëzimi i Brendshëm i DVP-së. Ato shpjeguan në detaje disa



nga ndryshimet e zbatuara.

### Takim në Drejtorinë e Rendit Publik në DPPSh.



Në vijim të punës për zbatimin e ndryshimeve në DVP –të e Tiranës, Durrësit dhe Fierit, EMP ka organizuar një numër takimesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në këtë kuadër janë takuar, Drejtori i rendit Publik Z. Ylli Vasili, Shefi i sektorit të Policimit në Komunitet Z. Zef Laska si dhe anëtarët e grupit të punës për projektin e ndryshimeve në nivel qendror në DPPSh. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë informimi dhe përditësimi i nivelit drejtues me progresin e arritur deri tani në këto DVP si dhe koordinimi i punës për të dy grupet e punës (në qendër dhe në DVP-të e sipër përmendur) për menaxhimin e ndryshimeve në kuadër të ndjekjes periodike të zbatimit të ndryshimeve sipas planit të punës të projektuar nga Grupi i Punës të projektit të menaxhimit të ndryshimeve në këto DVP.





**Takime monitoruese në komisariatet DVP Elbasan dhe Shkodër**



Gjatë muajit Janar 2022 ekipi i ekspertëve të SCPA zhvilloi takime në DVP Elbasan dhe Shkodër.

Takimet e para u mbajtën me drejtorin e sapoemëruar të DVP Elbasan, Z. Ardian Cipa, si dhe me nivelin drejtues të komisariatit të Elbasanit, Cërrikut dhe Peqinit. Kurse në Shkodër, ekipi i SCPA u takua me Drejtorin e DVP Shkodër Z. Hamdi Fjore, Zv. drejtorin për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet si dhe me nivelin drejtues të komisariatit të Shkodrës. Takimet e realizuara kishin për qëllim prezantimin me drejtorët dhe shefat e komisariateve të porsa emëruar dhe përditësimin e tyre me aktivitetet e kryera deri tani, dhe nga ana tjetër ekipi synoi të monitorojë vazhdimësinë e zbatimit të ndryshimeve të aplikuara në komisariatet e DVP Pilot të Elbasanit dhe atë të DVP Shkodër.

Pasi u paraqit një ekspozitë e punës së deritanishme, Ekipi

diskutoi me të dy drejtorët mbi objektivat për të siguruar një qëndrueshmëri të rezultateve të arritura si dhe mënyrën e implementimit dhe afatet kohore të zbatimit.

Në këto takime u adresuan një sërë çështjesh, siç janë zbatimi i sistemit me dy turne për SPZ-të, përshtatja e OPP-ve me detyrat e reja, sipas përshkrimeve të punës, etj. Ekspertët shpjeguan se është e një rëndësie thelbësore që të orientohen të komisarivateve si dhe specialistët e rendit dhe sigurisë publike të cilët kryejnë dhe funksionin e përgjegjësit të grupit/turnit, që të konsolidohet një rol më aktiv i OPP-ve në menaxhimin e të gjithë zinxhirit të punës në vend -ngjarje.

Shefat e komisariateve informuan ekspertët për hapat e ndërmarrë deri më tani për të zbatuar ndryshimet e parashikuara nga Urdhri i DP dhe Udhëzimi i Brendshëm i DVP-së. Ato shpjeguan në detaje disa

**Përfundon procesi i seleksionimit të projekteve fituese të raundit të 6-të**



Gjatë muajit janar 2021, përfundoi procesi i seleksionimit të projekteve fituese të raundit të 6-të për qarqet Durrës, Fier, Vlorë dhe Shkodër .

Afati i dorëzimit të aplikimeve ishte 17 dhjetor 2021, dhe pas shqyrtimit administrativ të aplikimeve u kalua në shqyrtimin e projekt propozimeve në baze të kriterëve teknike të vlerësimit.

Përzgjedhja e projekteve fituese u krye përmes komisioneve vendore përzgjedhëse, të cilat përbehen kryesisht nga përfaqësues të Drejtorive Vendore të Policisë të qarqeve përkatëse si dhe përfaqësues nga institucionet vendore.

Nga totali prej 20 aplikimeve të organizatave që iu përgjigjen Thirrjes për Aplikime nr. 6, u përzgjedhën 7 projekte fituese në qarqet e sipërpërmendura, zbatimi i të cilave do të fillojë gjatë muajit shkurt.

### Takime ndërgjegjësimi me të rinjtë e shkollës “Misto Mame”



Më datë 21. 01. 2022 pranë shkollës 9-vjecare publike “Misto Mame” u zhvillua një takim ndërgjegjëses mbi dhunën, bullizmin dhe diskriminimin. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Rritja e efikasitetit të parandalimit të dhunës në njësinë administrative nr. 8 Tiranë përmes përfshirjes së institucioneve, policisë dhe komunitetit”, që zbatohet nga

organizata NCCS, grantmarrëse e raundit të 5të të skemës së granteve. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm përfaqësues nga drejtoria e shërbimit social PMF, nga policia e shtetit OPK i zonës, psikologja e shkollës, staf i NCCS. Qëllimi i takimit ishte ndërgjegjësimi dhe informimi mbi parandalimin e fenomeneve të çdo forme të dhunës nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të

politikave parandaluese në bashkëpunim me të gjithë aktorët. Gjatë aktivitetit u diskutua gjithashtu mbi format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit ndaj fëmijëve. Të rinjtë shfaqën interes në marrjen e informacionit mbi pasojat e dhunës, mënyrat e raportimit dhe rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar ata gjatë përdorimit të internetit.

### NSPK-të për edukimin dhe punën me të rinjtë vazhdojnë punën për aktivitetet ndërgjegjëse



Nëpërmjet forumit online në internet, të ndërtuar posaçërisht për komunikimin e NSPK-ve për edukimin dhe punën me të rinjtë, programi SCPA në bashkëpunim me sektorin e PK informohen saktësisht për aktivitetet e ndryshme të organizuara në çdo DVP. Pavarësisht kufizimit nga pandemia Covid19, në shumë shkolla u organizuan aktivitete lidhur me ndërgjegjësimin dhe promovimin e vlerave për të rinjtë. Në periudhën e fundit gjashtë mujore deri në fund të muajit Janar 2022, janë zhvilluar më shumë se 109 aktivitete

ndërgjegjëse në shkolla të ndryshme dhe janë postuar 231 foto për të ilustruar aktivitetet e tyre. Në pararojë janë NSPK-të e komisariateve Durrës, Lezhë, Fier, Vlorë, Sarandë, Shkodër, Kukës, Cerrik dhe Elbasan. Programi ka arritur në përfundim se forumi për NSPK-të në Facebook vazhdon të jete një instrument i suksesshëm dhe shumica e pjesëmarrësve janë shumë aktivë me postimet dhe shkëmbimin e informacionit. Ky forum, tashmë ia ka arritur qëllimit të tij për të ndërtuar një frymë të fortë ekipi dhe

për të nxitur komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave në mesin e NSPK-ve për edukimin dhe punën me të rinjtë dhe ne synojmë ta rrisim atë gjatë periudhës në vijim. Për me tepër shiko: <https://www.facebook.com/>

